

FONDI SHOIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 22.12.2015]

Për: Shoqerine “I.C.C. GROUP” Shpk

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për Propozime”** me objekt : **“Rikonstruksioni i shkollës së mesme të bashkuar “Caush Senja”, Tunjë”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksioni i shkollës së mesme të bashkuar “Caush Senja”, Tunjë”.**

Kohëzgjatja: **2 (dy) muaj nga data e fillimit të punimeve.**

Fondi limit: **5.411.801 (pesë milionë e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e një) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: **Buxheti i Shtetit.**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 21.11.2015.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): **Nuk ka patur.**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	VLERA PA TVSH
1	I.C.C GROUP	3,784,654
2	LIQENI VII	4,084,132
3	PERPARIMI/G	4,124,911
4	SHQIPONJA-M	4,148,520
5	EGLAND	4,188,486
6	AURORA KONSTRUKSION	4,270,540
7	HASTOÇI	4,299,465
8	2 N	4,400,052
9	S I R E T A 2F	4,444,444
10	INA	4,458,900
11	FLED	4,571,530
12	BAHAS	4,603,370
13	"SHENDELLI"	4,618,476
14	"METEO".SH.p.k	4,810,570
15	KUPA	4,830,762
16	GLAVENICA	4,966,032
17	VELLEZERIT HYSA	5,165,120

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm me arsyet përkatëse:

“Liqeni VII” shpk per arsye se:

Nuk ploteson kushtin per kualifikim: *”Operatori Ekonomik duhet te disponoje vlera te mjaftueshme monetare per te realizuar objektin e tenderit pa marre paradhenie. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare në vlerë jo më të vogël se 10 % te vleres se fondit limit, të lëshuar jo më pare se 10 (dhjete) ditë nga dita e hapjes së ofertave”.* Vertetimet qe ai ka paraqitur mbajne daten 9 Nentor, pra me shume se 10 dite para dates 21.11.2015 qe ishte data e hapjes se ofertave.

Nuk ploteson kerkesen per kualifikimet e nevojshme te stafit drejtues pasi nuk ka ne staf inxhinier hidroteknik dhe per inxhinierin elektrik Bujar Gishti nuk ka paraqitur librezet e punes ne perputhje me kerkesen.

“Perparimi/G” shpk (60%) dhe “Beladi” shpk (40%) per arsye se:

Bashkimi i shoqerive nuk eshte bere ne perputhje me nenin 74, pika 2, te VKM nr. 914, date 29.12.2014 ku nder te tjera citohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.* Ne marreveshjen e lidhur para noterit eshte percaktuar vetem perqindja e pjesemarrjes per secilen shoqeri dhe nuk jane percaktuar elementet konkrete te punes qe do te kryeje secili nga anetaret e bashkimit. Kjo ben qe Komisioni i Vleresimit te Ofertave te mos gjykoje dot per plotesimin e kerkesave per kualifikim sipas puneve qe secila shoqeri ka marre persiper. Komisioni konsideron se secila shoqeri do te kryeje perqindjen perkatese per secilin ze punimesh.

Shoqeria “Perparimi/G” shpk nuk ploteson kushtin per pagesen e të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi nuk ka paraqitur vertetim lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore per bashkine Gramsh ne te cilen operatori ekonomik ushtron aktivitet.

Shoqeria “Perparimi/G” shpk nuk ploteson kerkesen per numrin mesatar te punonjesve per periudhen janar – shtator 2015. Sipas marreveshjes se bashkepunimit ka marre persiper 60% te punes, pra duhet te kete $20 \times 0.6 = 12$ punonjes. Faktikisht ka patur mesatarisht 9.2 punonjes. Faktikisht numri paraqitet si me poshte:

MUAJI	NUMRI	MUAJI	NUMRI
JANAR	6	QERSHOR	9
SHKURT	6	KORRIK	5
MARS	14	GUSHT	5
PRILL	12	SHTATOR	15
MAJ	11	SHUMA	83
		MESATARJA	9.2

Shoqeria “Perparimi/G” shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikimet e nevojshme te stafit drejtues pasi nuk ka paraqitur dokumentacion se ka ne stafin e vet inxhinier elektrik dhe inxhinier hidroteknik.

Shoqëria "Perparimi/G" shpk nuk disponon piken e licenses NS – 14.

Shoqëria "Perparimi/G" shpk nuk disponon certifikate ISO 9001:2008 mbi "Sistemet e menaxhimit te cilesise" dhe certifikate ISO 14001:2004 mbi "Sistemet e menaxhimit te ambjentit".

"Shqiponja - M" shpk per arsye se:

Nuk ploteson kerkesen per kualifikimet e nevojshme te stafit drejtues pasi ing. elektrik Kleand Ballabani eshte diplomuar ne vitin 2009, duke mos plotesuar vjetersine ne pune prej shtate vitesh.

Stafi i kesaj kompanie eshte i angazhuar ne dy kontrata te lidhura me Fondin Shqiptar te Zhvillimit, te cilat jane akoma ne proces realizimi.

"Egland" shpk per arsye se:

Nuk ploteson kushtin per shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqipëri, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per likuidimin e detyrimeve per muajin shtator, detyrim ky i maturuar para dates se tenderit.

Nuk ka paraqitur deklaraten e kerkuar ne kerkesen 2.4.2 per kualifikim, ku te deklarohet se punetoret nuk jane te angazhuar ne pune te tjera.

Nuk ploteson kerkesen per kualifikimet e nevojshme te stafit drejtues pasi ing. Ndertimit Mariola Dino eshte diplomuar ne vitin 2010, duke mos plotesuar vjetersine ne pune prej shtate vitesh. Po ashtu edhe ing. hidroteknik Jurgen Ocelli eshte diplomuar ne vitin 2009 duke mos e plotesuar kete kusht.

"2 N" shpk per arsye se:

Nuk ka paraqitur ekstraktin e regjistrit tregtar.

Nuk ka paraqitur vertetim nga banka se disponon vlera te mjaftueshme monetare per te realizuar objektin e tenderit pa marre paradhenie.

Per objektin e ngjashem te deklaruar nuk ka paraqitur kontraten, aktin e kolaudimit dhe faturat tatimore.

Nuk ka paraqitur dokumentacion per stafin teknik te shoqerise.

Nuk disponon piken e kerkuar te licenses NS – 14.

"Ina" shpk per arsye se:

Nuk ploteson kerkesen per kualifikimet e nevojshme te stafit drejtues pasi nuk ka paraqitur diplomat per ing ndertimit Tatiana Andoni, ing elektrik Ilirian Peco dhe ing hidroteknike Alma Brati.

"Fled" shpk per arsye se:

Nuk ploteson kerkesen per realizimin e puneve te ngjashme pasi per objektin e deklaruar "Shkolla Frasher" nuk ka paraqitur faturat tatimore.

Nuk ploteson kërkesen për kualifikimet e nevojshme të stafit drejtues pasi për inxhinieret nuk ka paraqitur librezat e punës.

“Bahas” shpk per arsye se:

Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për realizimin e punëve të ngjashme.
Nuk ploteson kërkesen për kualifikimet e nevojshme të stafit drejtues pasi nuk ka paraqitur librezat e punës për inxhinierin elektrik Fatmir Macaj. Gjithashtu inxhinieri hidroteknik Klens Jahja është diplomuar në vitin 2013 duke mos plotësuar vjetërsinë në punë.

“Shendelli” shpk per arsye se:

Nuk ploteson kërkesen për kualifikim: “Operatori Ekonomik duhet të disponojë vlera të mjaftueshme monetare për të realizuar objektin e tenderit pa marrë paradhenie. Për të vertetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare në vlerë jo më të vogël se 10 % të vlerës së fondit limit, të lëshuar jo më parë se 10 (dhjetë) ditë nga dita e hapjes së ofertave” pasi vertetimi nga banka është lëshuar në datën 09.11.2015 dhe i ka kaluar afati 10 ditor i vlefshmerisë, pasi data e hapjes së ofertave ka qenë 21.11.2015.

“Meteo” shpk per arsye se:

Në sistemin elektronik të prokurimit nuk ekziston asnjë dokument i kësaj shoqërie. Të gjithë dokumentat janë të shoqërisë “Ergi” shpk. Duke qenë se nuk ka asnjë lidhje midis këtyre dy shoqërive Komisioni vendosi të mos shqyrtojë asnjë dokument.

“Kupa” shpk per arsye se:

Nuk ploteson kërkesen për kualifikim “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për shlyerjen e taksave vendore në Sukth-Hamallaj-Durrës, Tiranë dhe Qerret-Kavajë, vende ku ushtron aktivitet sipas QKR.

“Glavenica” shpk (70%) dhe “Vllaznia” shpk (30%) per arsye se:

Nuk ka paraqitur asnjë dokument për shoqërinë “Vllaznia” shpk e cila ka marrë persiper të kryeje 30% të volumit të punimeve.

“Vellezerit Hysa” shpk per arsye se:

Nuk ka paraqitur vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 11 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore”.

Nuk ploteson kërkesen për kualifikim “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për likuidimin e taksave vendore në Klos-Banjë dhe në komunën Shushicë për vitin 2015.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë “I.C.C. Group” shpk se oferta e paraqitur, me vlerë 3.784.654 (tre milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **04.12.2015**.

Ankesa: Në datën 12.11.2015 ka paraqitur ankesë shoqëria “Avduli” shpk ne lidhje me kerkesat per kualifikim. Ankesës ju dha përgjigje në datën 13.11.2015. dokumentat u modifikuan nepermjet nje shtojce dhe afati i hapjes se tenderit u shty me pese dite. Ne daten 07.12.2015 paraqiti ankim shoqeria “Perparimi G” shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 11.12.2015 duke e refuzuar ate. Ankesa te tjera nuk ka patur.

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK